



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 894/prot.
16

Tiranë, më 16.05.2018

URDHËR

Nr. 688, datë 16.05.2018

PËR

MIRTATIMIN E "PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2018-2020 NË
FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar;
të shkronjës "F", të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e
drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e dokumentit "Plani i veprimit për barazinë gjinore 2018-2020 në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij urdhri.
2. Përgjigjen për zbatimin e këtij urdhri: komandantët e Forcave, komandanti i Komandës së Mbështetjes, komandanti i Komandës së Doktrinave dhe Stërvitjes, AISM, Qendra e Personel-Rekrutimit, ASNI, Batalioni i Policisë Ushtarake, Njësia Mjekësore Ushtarake e Forcave të Armatosura, Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i FA-së, drejtoritë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së.
3. Ndjek zbatimin e këtij urdhri sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

